

FAKULTETI EKONOMIK

Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren

Rr. Shkronjave 1, 20000 Prizren

Republika e Kosovës

FAKULTETI EKONOMIK

PLANI STRATEGJIK

2020-2024

FAKULTETI EKONOMIK
Plani Strategjik
2020-2024
Në hap me kohën

Prizren, Dhjetor 2019



SHKURTESAT

AKA	Agjencia e Kosovës për Akreditim
BE	Bashkimi Evropian
BKI	Bordi Këshilldhënës Industrial
ESG	Standardet Evropiane të Cilësisë
KK	Kuvendi Komunal
KShC	Këshilli Shtetëror i Cilësisë
MASHT	Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë
MF	Ministria e Financave
MM	Memorandum Mirëkuptimi
NJA	Njësitë Akademike
PS	Parlamenti Studentor
QKA	Qendra e Karrierës dhe Alumnit
TI	Teknologjia e Informacionit

PËRMBAJTJA

Fjala e dekanit

Historiku i Fakulteti Ekonomik

1. Themelet e planit strategjik

- 1.1. Misioni
- 1.2. Vizioni
- 1.3. Objektivat
- 1.4. Vlerat
- 1.5. Grupet e interesit

2. Procesi i planifikimit strategjik

- 2.2. Analiza e pozicionimit (SWOT analiza)

3. Objektivat strategjike

- 3.1. Sigurimi i cilësisë në mësimdhënie dhe mësimnxënie
- 3.2. Zhvillimi i punës kërkimore-shkencore
- 3.3. Kontributi në komunitet
- 3.4. Procesi i ndërkombëtarizimit dhe rrjetëzimit
- 3.5. Zhvillimi i infrastrukturës
- 3.6. Qëndrueshmëria financiare

4. Plani i veprimit



FJALA E DEKANIT

Plani Strategjik 2020-2024 i Fakultetit Ekonomik (në tekstin e mëtejme FE) u hartua pas një procesi gjithpërfshirës të konsultimit me të gjitha palët e interesit, brenda dhe jashtë fakultetit. Nëpërmjet këtij plani strategjik, FE ka definuar qartë dhe saktë objektivat afatmesëm dhe afatgjatë të zhvillimit, në përputhshmëri me pritjet e personelit akademik, studentëve dhe komunitetit.

Ne si drejtues të FE, jemi të bindur që me përmbushjen e prioriteteve dhe objektivave të këtij plani strategjike, institucioni ynë do të pozicionohet si lider në ofrimin e edukimit cilësorë në fushën e menaxhmentit ndërkombëtar, administrimit të biznesit dhe kontabilitet-auditimit.

Përmbushja e projeksioneve të planit strategjik do ta bëjë FE konkurrues në fushën e kërkimeve shkencore dhe ofrimin e shërbimeve të konsulencës për nevojat e komunitetit. Vendorsja e bashkëpunimit të ngushtë me komunitetin, nëpërmejt themelimit të Bordit Këshilldhënës Industrial (BKI) do të ndërtojë urat e bashkëpunimit të ngushtë me komunitetin e biznesit dhe institucionet tjera publike/private.

Përfundimisht, nëpërmjet marrëveshjeve të reja të bashkëpunimit me fakultetet simotra të rajonit dhe ato Evropiane, FE mëton të krijoj një partneritet të konsoliduar ndërkombëtar dhe të rritë aktivitetet e saj drejt përmbushjes së objektivave strategjike të ndërkombëtarizimit, duke u identifikuar kështu si institucion i hapur dhe cilësor jo vetëm në tregun kombëtar por edhe në atë rajonal dhe më gjerë.

Prof. Asoc. Dr. Halil Kukaj
Dekan, Fakulteti Ekonomik

HARTIMI I PLANIT STRATEGJIK

Ky plan strategjik është hartuar në bazë të vendimit të Këshillit Drejtues të UUHP (në tekstin e mëtejme Universiteti) me nr. ref. 01-391 dt. 10.10.2019. Plani Strategjik 2020-2024 është hartuar pas konsultimeve intensive dhe gjithpërfshirëse të akterëve të brendshëm dhe të jashtëm të FE. Të gjitha aktivitetet zhvillimore të FE do të mbështeten dhe udhëhiqen nga ky plan strategjik.

Anëtarët e komisionit të hartimit të planit strategjik

Prof. Asoc. Dr. Behxhet Brajshori, kryetar
Prof. Ass. Dr. Rifat Hoxha, anëtar
Ass. Anera Alishani, anëtare
MSc. Naser Buzhala, anëtar
Selami Gashi, anëtar (përfaqësues i studentëve)
Fisnik Haziraj, anëtar (përfaqësues i Alumni)
Xhafer Ponik, anëtar (përfaqësues i KK Prizren)
Qëndresa Januzaj, anëtar (përfaqësues i komunitetit të biznesit)
Liman Asllani, anëtar (përfaqësues i OJQ)

HISTORIKU I FAKULTETIT EKONOMIK

Fakulteti Ekonomik (FE) u themelua në vitin 2010. Ideja fillestare për themelimin e FE ka lindur si nevojë imediate e kërkesës së tregut për specialistë të fushës së menaxhimit dhe administrimit të biznesit dhe financave të kompanive në rajonin e Prizrenit. Për më tepër FE i kontribuon komunitetit të biznesit nëpërmjet përgaditjes së kuadrove për ndërkombëtarizimin e kompanive rajonale dhe vendore nëpërmjet programeve studimore të menaxhmentit ndërkombëtar.

Aktualisht, në FE studiojnë rreth 758 studentë. Studentët të cilët regjistrohen në FE kryesisht kanë origjinë nga rajoni i Prizrenit (Prizren, Suharekë, Rahovec, Malishevë dhe Dragash), nga qyteti i Gjakovës dhe një numër i studentëve janë me origjinë nga pjesa veriore e Shqipërisë. Struktura e moshës së studentëve është kryesisht e re. Prejardhja socio-ekonomike e studentëve të FE është e nivelit mesatar ashtu siç është edhe gjendja socio-ekonomike e popullatës të rajonit të Prizrenit.

Aktualisht, FE organizon programet e studimeve në dy nivele, atë bachelor dhe master. Njëkohësisht, brenda një periudhe afatmesme, FE planifikon të hap edhe programin e studimeve të doktoratës.

Programet e studimit në nivelin Bachelor:

- Administrim Biznesi dhe
- Menaxhment Ndërkombëtar.

Programet e studimit në nivelin Master:

- Administrim Biznesi, dhe
- Kontabilitet dhe Auditim.

Stafi akademik, në marrëdhënie të rregullt pune në FE, ka përgatitje të lartë akademike dhe profesionale. Ata marrin pjesë në mënyrë aktive në kongrese, konferenca, seminare dhe punëtori kërkimore-shkencore. Po ashtu, stafi akademik i FE është edhe bashkë-organizator i konferencave shkencore rajonale dhe ndërkombëtare. Studentët e FE janë pjesë aktive e aktiviteteve shkencore, në bashkëpunim të ngushtë me stafin akademik.

Për të avancuar edhe më tutje punën kërkimore-shkencore, në kuadër të FE është themeluar Instituti kërkimor-shkencor. Gjithashtu, me përkrahjen e programit Erasmus+ funksionon Qendra për Inovacione dhe Punësim. Të dy këto zyre, ndihmojnë në realizimin e projekteve hulumtuese, në thellimin e bashkëpunimit me profesorë dhe hulumtues ndërkombëtar dhe për mobilitet të stafit akademik si dhe të studentëve..

Kontributi në Komunitet i FE është jetik për zhvillimin e FE. Për këtë qëllim është themeluar Bordi Këshillëdhënës Industrial (BKI) i cili i shërben FE për komunikim dhe ndërveprim me komunitetin rajonal të biznesit dhe më gjerë.

Objekti i FE gjendet brenda kampusit të Universitetit, në afërsi të parkut të Prizrenit. Infrastruktura e FE përbëhet nga: 9 salla mësimi, 1 Amfiteatër, 8 zyre për stafin akademik 6 zyre për menaxhmentin e FE dhe stafin administrativ dhe zyre të tjera të ndara në 3 kate me një sipërfaqe totale prej rreth 3,500 m². Objekti i FE posedon Bibliotekën e cila ka një fond prej 1,159 tituj librash në gjuhën shqipe, angleze, turke, boshnjake si dhe në gjuhë të tjera. Kabineti i Informatikës është gjithashtu pjesë e rëndësishme e FE, për zhvillimin e procesit mësimor si dhe për aktivitete të tjera kërkimore-shkencore.

1. THEMELET E PLANIT STRATEGJIK

Vendimet strategjike të Fakultetit Ekonomik bazohen në trashëgiminë historike, traditën biznesore dhe tregtare të rajonit të Prizrenit si dhe veçoritë e diversitetit kulturor dhe gjuhësor të saj.

- Fakulteti Ekonomik është **institucion publik** i konsoliduar si njësi akademike në kuadër të Universitetit. Ky fakultet është ndërtuar mbi themelet e një makromjedisi me trashëgimi të pasur biznesore, zejtare, shkencore, kulturore dhe historike të rajonit.
- Selia e Fakultetit Ekonomik gjendet në **qytetin e Prizrenit**. Ky qytet njihet zyrtarisht si kryeqytet historik i Republikës së Kosovës. I njohur ndryshe si selia e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit dhe si djep i historisë, kulturës, artit dhe shkencës.
- Komuniteti në të cilin zhvillon aktivitetin e vet Fakulteti Ekonomik njihet për **tradi të në biznes**. Historikisht, ky komunitet ka kontribuar në zhvillimin e gjithëmbars hëm ekonomik rajonal, kombëtar dhe më gjerë.
- Makromjedisi në të cilin vepron Fakulteti Ekonomik karakterizohet me një **diversitet gjuhësor, etnik dhe fetar**. Ky diversitet paraqet një vlerë të shtuar për Fakultetin Ekonomik.
- Fakulteti Ekonomik i ka **4 programe studimore**, 2 në nivelin bachelor dhe 2 në nivelin master.
- Fakulteti Ekonomik ka **standardizuar infrastrukturën dhe hapësirat për studim** në përputhje me nevojat dhe kërkesat e e studentëve, stafit akademik dhe stafit administrativ.

- Fakulteti Ekonomik ka ndërkombëtarizuar aktivitetet e saj nëpërmjet **rrjetëzimit ndërkombëtar** duke nënshkruar një numër të konsiderueshëm të marrëveshjeve të bashkëpunimit.
- Fakulteti Ekonomik ka konsoliduar **biblotekën e fakultetit dhe bibliotekën elektronike** duke e pasuruar atë me një fond të madh të librave për nevoja të programeve studimore dhe kërkime shkencore.
- Fakulteti Ekonomik ka ndërtuar një **lidhje të ngushtë me komunitetin e biznesit**. Për këtë qëllim ka themeluar Bordin Këshilldhënës Industrial (BKI).

1.1. Misioni

Fakulteti Ekonomik ka për mision ofrimin e edukimit cilësor kompatibel me standardet akademike në fushën e ekonomisë, ndërtimin e kapaciteteve kërkimore-shkencore të cilat i shërbejnë komunitetit për avancimin e shkathtësive dhe përvojave për punësim, inovacion, zhvillim ekonomik dhe mirëqenie sociale.

1.2. Vizioni

Vizioni i Fakultetit Ekonomik mbështetet në arritjen dhe në krijimin e konkurrencës në tregun e dijes, të hulumtimeve shkencore, si dhe të mobilitetit studentor dhe akademik me Fakultetet Ekonomike të Universiteteve të vendeve të rajonit dhe vendeve Evropiane.

1.3. Objektivat

- Avancimin e kurrikulave të programeve studimore dhe përshtatshmërinë e tyre me kërkesat e tregut;
- Aplikimi i metodave bashkëkohore të edukimit përmes zbatimit të teknologjisë së avancuar informative;
- Zgjerimin e rrjetit të partnerëve akademik ndërkombëtar dhe shkëmbimi i përvojave të mira;
- Avancimi i kapaciteteve kërkimore-shkencore në fushat me interes për FE;
- Rritja e pjesëmarrjes në aktivitete shkencore (kongrese, konferenca, seminare, punëtori etj).
- Përfshirja më e gjerë e studentëve në mobilitet, hulumtime dhe projekte kërkimore-shkencore të përbashkëta me stafin akademik;

- Thellimi i bashkëpunimit dhe këmbimi i përvojave me komunitetin biznesor, duke përfshirë NVM-të,
- Kultivimi i marrëdhënieve bashkëpunuese me akterët e jashtëm, përfshirë këtu Alumni (studentët e diplomuar), organizatat qeveritare, OJQ dhe komunitetin e biznesit.

1.4. Vlerat

FE promovon vlerat universale, grupe dhe individuale si vijon:

- **Liria e shprehjes dhe punës akademike-shkencore** në mënyrë që të sigurohet shprehja e mendimit ndryshe;
- **Ngritja e vazhdueshme e cilësisë** në procesin e edukimit dhe punën kërkimore-shkencore;
- **Konkurrenshmëria** brenda fakultetit si vlerë e shtuar zhvillimit akademik dhe shkencor;
- **Transparenca** dhe shprehja e mendimit kritik;
- **Kohezioni me kërkesat e tregut** të punës;
- **Meritokracia** si vlerë universale e njohjes së kontributeve individuale dhe grupe;
- **Diversiteti linguistik, etnik dhe kulturor** si vlerë e shtuar burimore nga makromjedisi i rajonit të Prizrenit;
- **Barazia sociale dhe gjinore** si vlerë e fuqizimit të shtresave sociale të marginalizuara dhe rolit të gruas;
- **Qëndrueshmëria financiare** nëpërmjet diversifikimit të burimeve të financimit të aktiviteteve të FE;
- **Bashkëpunimi i ngushtë me komunitetin e biznesit** të rajonit të Prizrenit

1.5. Palët e interesit

Fakulteti Ekonomik e planifikon zhvillimin e saj strategjik për periudhën 2020-2024 duke u mbështetur në bashkëpunimin dhe ndërveprimin e ngushtë me palë e interesit të cilët janë aktiv brenda dhe jashtë mjedisit të FE.

Palët e brendshme të interesit:

STAFI AKADEMIK

Stafi akademik përbënë bartësit kryesorë të procesit edukativ dhe aktiviteteve kërkimore-shkencore. Ky grup i interesit përfaqësohet nga profesorët e rregullt, profesorët e angazhuar, asistentët dhe bashkëpunëtorët shkencor. Stafi akademik i rregullt kategorizohet sipas thirrjes akademike në Prof. Asoc. Dr., Prof. Ass. Dr. dhe Ass.

STAFI ADMINISTRATIV DHE TEKNIK

Stafi administrativ dhe teknik përbën palët e brendshme të interesit të cilët kryejnë funksionet operative dhe teknike të FE.

- Sekretari
- Zyrtarët për shërbime studentore (Baçelor dhe Mastër)
- Bibliotekari
- Personeli teknik

MENAXHMENTI I FAKULTETIT EKONOMIK

Menaxhmenti i FE përbën organet udhëheqëse që përkujdeset për menaxhimin dhe mbarëvajtjen e punës edukative-kërkimore.

- Dekani
- Prodekani
- Këshilli i Fakultetit
- Këshilli i Cilësisë në nivel të fakultetit

Palët e jashtme të interesit:

STUDENTËT

Studentët janë përfituesit më të mëdhenj të procesit të krijimit dhe transferit të dijes. Këtë grup të interesit e përbëjnë studentët kosovar dhe ata ndërkombëtarë, përfshirë këtu studentët e rregullt dhe studentët në marrëdhënie pune.

ALUMNI (STUDENTËT E DIPLOMUAR)

Alumni janë studentët e diplomuar të cilët vazhdojnë të gëzojnë shërbimet e FE si dhe të kontribuojnë në lidhjen e urave të komunikimit të FE me komunitetin e jashtëm. Ky grup i interesit mund të krijojë komunitetin e vet pas përfundimit të studimeve.

KOMUNITETI I BIZNESIT

Komuniteti i biznesit është palë strategjike e interesit e cila përbëhet nga përfaqësuesit e industrisë dhe bizneset lokale dhe ndërkombëtare. FE bashkëpunon ngushtë me komunitetin e biznesit nëpërmjet Bordit Këshilldhënës Industrial (KBI).

AUTORITETI QEVERITAR LOKAL DHE QENDROR

Autoriteti qeveritar në nivel lokal dhe qendror përbën një aktor të rëndësishëm në zbatimin e planit strategjik. Në këtë kuadër përfshihen përfaqësuesit e Kuvendeve Komunale të rajonit të Prizrenit, MASHT, Ministria e Financave etj.


KOMUNITETI I JASHTËM AKADEMIK DHE SHKENCOR

Komuniteti i jashtëm akademik dhe shkencor përbëhet nga partnerët e jashtëm strategjik, duke përfshirë këtu Shkollat e Mesme, Fakultetet simotra brenda dhe jashtë Republikës së Kosovës, Institutet kërkimore-shkencore etj.


Statistika të përmblledhura BA

Statistika të përmblledhura Msc


Numri i studentëve aktiv




Struktura gjinore e studentëve




Studentët sipas vendlindjes



Numri i studentëve aktiv




Struktura gjinore e studentëve




Statistikat e stafit akademik


Personeli akademik i rregullt



Stafi mbështetës administrativ dhe teknik



Numri i punimeve shkencore të stafit akademik



2. PROCESI I PLANIFIKIMIT STRATEGJIK

Fakulteti Ekonomik synon **ngritjen e vazhdueshme të cilësisë**, nëpërmjet promovimit të sinergjisë midis procesit të edukimit dhe punës kërkimore-shkencore bazuar në përvojat e mira Evropiane.

Në këtë drejtim, ky Plan strategjik mëton të **identifikojë objektivat strategjike të zhvillimit** të fakultetit në periudhën afatmesme 2020-2024.

Plani Strategjik është hartuar për herë të parë për periudhën 2020-2024 dhe mbështetet në **qasjen evolutive të objektivave strategjike** të Fakultetit Ekonomik, në përputhje me kontekstin e nevojave dhe kërkesave të përditësuara sociale, legjislative dhe tregut të punës.

Në këtë Plan Strategjik **identifikohen rezultatet e pritura** në kuadër të secilit objektiv strategjik. Njëkohësisht, ky Plan Strategjik përfshinë edhe Planin e Veprimit në kuadër të të cilit planifikohen aktivitetet, masat, afatet kohore të zbatimit, bartësit dhe kostot e financimit.

Në kuadër të Planit Strategjik 2020-2024, Fakulteti Ekonomik ka identifikuar **6 objektiva strategjike** që inkorporojnë në vete: sigurimin e cilësisë në mësimdhënie dhe mësimnxënie, punën kërkimore-shkencore, kontributin në komunitet, procesin e ndërkombëtarizimit dhe rrjetëzimit, zhvillimin e infrastrukturës si dhe qëndrueshmërinë financiare.

Për zbatimin e Planit Strategjik 2020-2024, Fakulteti Ekonomik ka themeluar një **këshill mbikqyrës** në përbërje mikse nga përfaqësuesit e stafit akademik, studentëve dhe komunitetit.

Fuqitë

- Programe cilësore dhe atraktive të studimit (Bc. dhe Msc.)
- Kredencialet akademike të standardizuara me ato të BE
- Studenti është në qendër të vëmendjes
- Kosto e përballueshme e studimit për studentë
- Selia e fakultetit në qytetin me traditë kulturore dhe biznesore
- Komunikimi dhe ndërveprimi intensiv student-profesor
- Diversiteti etnik, kulturor dhe fetar i studentëve
- Këshillim i personalizuar për studentë
- Liria e fjalës dhe e të shprehurit

- Zgjerimi i rrjetëzimit me fakultetet rajonale dhe ndërkombëtare
- Lokacioni atraktiv lokal (trashëgimia historike, tradita biznesore)
- Avancimi i punës praktike me partnerët e komunitetit të biznesit
- Ofrimi i kurseve (moduleve) online për studentët e huaj
- Hapja e programeve studimore në gjuhën angleze
- Përfitimet e komunikimit me alumni (studentët e diplomuar)
- Ofrimi i studimeve në programin e doktoratës

Mundësitë

Dobësitë

- Numri i kufizuar i programeve studimore
- Marrëdhëniet e kufizuara me komunitetin e jashtëm
- Kufizimi i mobilitetit si rezultat i regjimit të vizave
- Përkrahja e kufizuara financiare për punën kërkimore
- Produktiviteti i ulët i punës kërkimore-shkencore
- Infrastruktura e vjetërsuar (IT, kabineti i informatikës etj.)
- Kufizimi në rekrutimin e stafit akademik

- Konkurrenca jolojale nga kolegjet private
- Ndryshimet demografike dhe emigrimi i të rinjve
- Kufizimet buxhetore të financimit të projekteve
- Akreditimi institucional i universitetit
- Qasja e kufizuar në tregun Evropian të punës
- Shkalla relativisht e ulët e punësimit të të rinjve
- Adaptimi me trendet e reja të teknologjisë
- Fluktuimi i stafit akademik në institucione tjera

Rreziqet

3. OBJEKTIVAT STRATEGJIKE

Plani strategjik i FE ndërtohet në kornizën e 6 (gjashtë) objektivave strategjike:

- Sigurimi i cilësisë në mësimdhënie dhe mësimnxënie;
- Zhvillimi i punës kërkimore-shkencore;
- Kontributi në komunitet;
- Procesi i ndërkombëtarizimit dhe rrjetëzimit;
- Zhvillimi i infrastrukturës, dhe
- Qëndrueshmëria financiare.

Këto objektiva strategjike zbërthehen në rezultate të pritura me interes strategjik për FE.

3.1. Sigurimi i cilësisë në mësimdhënie dhe mësimnxënie

Në kuadër të këtij objekti strategjik Fakulteti Ekonomik ka përcaktuar këto rezultate të pritura:

- **Rezultati i pritur 1.1:** Sigurimi, monitorimi dhe kontrolli i vazhdueshëm i cilësisë;
- **Rezultati i pritur 1.2:** Përsosshmëria e proceseve dhe procedurave për sigurimin dhe kontrollin e cilësisë;
- **Rezultati i pritur 1.3:** Hapja e 3 (tre) programeve të reja studimore (programi në nivelin Baçelor në gjuhën angleze; programi Master dhe programi i Doktoratës);
- **Rezultati i pritur 1.4:** Rritja e kapaciteteve të mësimdhënies me staf të ri akademik;
- **Rezultati i pritur 1.5:** Avancimi profesional i stafit akademik.

3.2. Zhvillimi i punës kërkimore-shkencore

Në kuadër të këtij objekti strategjik Fakulteti Ekonomik ka përcaktuar këto rezultate të pritura:

- **Rezultati i pritur 2.1:** Ngritja dhe zhvillimi i kapaciteteve të Institutit të Fakultetit Ekonomik;
- **Rezultati i pritur 2.2:** Përmirësimi i gjendjes në fushën e kërkimore-shkencore;
- **Rezultati i pritur 2.3:** Pjesëmarrja aktive e stafit akademik në kongrese, konferenca, seminare dhe punëtori;
- **Rezultati i pritur 2.4:** Përfshirja më e madhe e studentëve në punën kërkimore-shkencore;
- **Rezultati i pritur 2.5:** Rritja e numrit të punimeve shkencore të botuara në revista të indeksuara në Web of Science (WoS) dhe Scopus.

3.3. Kontributi në komunitet

Në kuadër të këtij objekti strategjik Fakulteti Ekonomik ka përcaktuar këto rezultate të pritura:

- **Rezultati i pritur 3.1:** Zhvillimi i bashkëpunimit me Bordin Këshilldhënës Industrial (BKI);
- **Rezultati i pritur 3.2:** Bashkëpunimi me komunitetin e biznesit, Alumni dha akterët tjerë në hartimin e programve studimore në harmoni me kërkesat e tregut;
- **Rezultati i pritur 3.3:** Bashkëpunimi në fushën e zhvillimit të praktikës profesionale të studentëve;
- **Rezultati i pritur 3.4:** Ofrimi i shërbimeve profesionale për nevojat e komunitetit.

3.4. Procesi i ndërkombëtarizimit dhe rrjetëzimit

Në kuadër të këtij objekti strategjik Fakulteti Ekonomik ka përcaktuar këto rezultate të pritura:

- **Rezultati i pritur 4.1:** Rritja e numrit të marrëveshjeve me Universitete ndërkombëtare;
- **Rezultati i pritur 4.2:** Anëtarësimi në organizata dhe asociacione të fakulteteve me profil ekonomik;
- **Rezultati i pritur 4.3:** Rritja e mobilitetit të stafit akademik dhe të studentëve;
- **Rezultati i pritur 4.4:** Bashkëpunimi me staf akademik ndërkombëtar për botimin e punimeve shkencore dhe organizimin e konferencave të përbashkëta.

3.5. Zhvillimi i infrastrukturës

Në kuadër të këtij objekti strategjik Fakulteti Ekonomik ka përcaktuar këto rezultate të pritura:

- **Rezultati i pritur 5.1:** Përmirësimi i kapaciteteve të kabinetit të informatikës;
- **Rezultati i pritur 5.2:** Instalimi i softvarit për Analiza Statistikore dhe Ekonometrike (STATA);
- **Rezultati i pritur 5.3:** Rritja e numrit të titujve të librave dhe literaturës shkencore në Biblioteken e FE;
- **Rezultati i pritur 5.4:** Avancimi i teknologjisë së mësimdhënies dhe vlerësimit të njohurive të studentëve;
- **Rezultati i pritur 5.5:** Përshtatja e sallave të mësimit me metodat e reja të mësimdhënies.

3.6. Qëndrueshmëria financiare

Në kuadër të këtij objekti strategjik Fakulteti Ekonomik ka përcaktuar këto rezultate të pritura:

- **Rezultati i pritur 6.1:** Projektet e përbashkëta me komunitetin lokal të biznesit;
- **Rezultati i pritur 6.2:** Projektet e përbashkëta kërkimore-shkencore me partnerët strategjik kombëtar dhe ndërkombëtar;
- **Rezultati i pritur 6.3:** Gjenerimi i të hyrave vetanake nga hartimi i planeve të biznesit, nga ekspertizat për nevojat e komunitetit të biznesit dhe për nevojat e institucioneve publike (gjykata, spitale, polici, auditim, etj);
- **Rezultati i pritur 6.4:** Të hyrat nga pagesat e studentëve.

Kampusi i FE

Infrastruktura e FE



3,500 m²

9 Salla Mësimi

1 Amfiteatro

1 Bibliotekë

1 Kabinet të Informatikës

8 Zyre për Personelin Akademik

1 Sallë për Profesorët

3 Zyre për Menaxhmentinn e FE

3 Zyre për personelin administrativ
1 Zyre për IT

1 Zyre për Qendrën për Inovacione dhe Punësim

1 Zyre për studentë
1 Zyre për Këshillin Drejtues të Universitetit

4. PLANI I VEPRIMIT

Nr.	Rezultatet e pritura	Aktivitetet	Masat	Strukturat përgjegjëse	Afati kohorë	Kostoja (Euro)
Objektivi strategjik 1: Sigurimi i cilësisë në mësimdhënie dhe mësimnxënie						
1.1.	Sigurimi, monitorimi dhe kontrolli i vazhdueshëm i cilësisë në procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Themelimi dhe funksionalizimi i Komisionit të sigurimit të cilësisë të Fakultetit Ekonomik ▪ Ofrimi i kurseve elektronike 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Monitorimi dhe kontrolli i vazhdueshëm i procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies 	Këshilli i FE, Dekani, Këshilli i Cilësisë	2020-2024	10,000
1.2.	Përsosshmëria e proceseve dhe procedurave për sigurimin, monitorimin dhe kontrollin e cilësisë	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Monitorimi dhe kontrolli i vazhdueshëm i mësimdhënies dhe mësimnxënies 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Zbatimi i pyetësorëve dhe raporteve të sigurimit të cilësisë të paraparë sipas Rregullores për sigurimin e cilësisë dhe Udhëzuesit për vlerësimin e stafit akademik, lëndës, programeve studimore 	Këshilli i FE, Dekani, Këshilli i Cilësisë	2020-2024	5,000
1.3.	Hapja e 3 (tre) programeve të reja të studimit: <ul style="list-style-type: none"> ▪ Baçelor (në gjuhën angleze): <i>“Ekonomiks i inovacionit”</i> ▪ Master: <i>“Menaxhimi i institucioneve financiare”</i> ▪ Doktoratë: <i>“Administrim biznesi dhe përgjegjësia sociale”</i> 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Marrja e vendimit për bartësit e të 3 (tre) programeve të reja ▪ Ndarja e detyrave për hartimin e RVV për të tre programet e reja studimore 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Hartimi i RVV për programin Baçelor ▪ Hartimi i RVV për programin Master ▪ Hartimi i RVV për programin e Doktoratës 	Këshilli i FE, Dekani, Rektorati, Senati i Universitetit	2020-2024	8,000
1.4.	Rritja e kapaciteteve të mësimdhënies me staf akademik	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Rekrutimi i 7 (shtatë) profesorëve të rregullt dhe i 3 (tre) asistentëve 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Rekrutimi i stafit të ri akademik ▪ Komisionet recensuese ▪ Komisionet e ankesave ▪ Vendimi i Senatit 	Këshilli i FE, Dekani, Senati i Universitetit	2020-2024	350,000

1.5.	Avancimi profesional i stafit akademik	<ul style="list-style-type: none"> Organizimi i trajnimeve për mësimdhënie dhe mësimnxënie i stafit akademik 	<ul style="list-style-type: none"> Pjesëmarrja e stafit akademik në trajnime 	Këshilli i FE, Dekani	2020-2024	5,000
Objektivi strategjik 2: Zhvillimi i punës kërkimore-shkencore						
2.1.	Ngritja dhe zhvillimi i kapaciteteve të Institutit të Fakultetit Ekonomik	<ul style="list-style-type: none"> Ndarja e buxhetit për funksionalizimin e Institutit Angazhimi i bashkëpunëtorit të jashtëm shkencor 	<ul style="list-style-type: none"> Krijimi i hapësirave për zhvillimin e aktiviteteve të Institutit Paisja me inventarin dhe teknologjinë e nevojshme Rekrutimi i 1 (një) bashkëpunëtorit të jashtëm shkencor 	Këshilli i FE, Dekani, Stafi akademik, Rektorati, Senati i Universitetit	2020-2024	56,000
2.2.	Përmirësimi i gjendjes në fushën kërkimore-shkencore	<ul style="list-style-type: none"> Hartimi i planit vjetor për punën kërkimore-shkencore Identifikimi i platformave për publikime shkencore 	<ul style="list-style-type: none"> Krijimi i komisionit për hartimin e planit vjetor Krijimi i komisionit për identifikimin e platformave për publikimet online 	Këshilli i FE, Dekani, Stafi akademik	2020-2024	2,000
2.3.	Pjesëmarrja aktive e stafit akademik në kongrese, konferenca, seminare dhe punëtori	<ul style="list-style-type: none"> Pjesëmarrja në kongrese dhe konferenca të fushës së ekonomisë 	<ul style="list-style-type: none"> Mbështetja financiare për pjesëmarrje në kongrese, konferenca, punëtori etj 	Këshilli i FE, Dekani, Stafi akademik	2020-2024	100,000
2.4.	Rritja e numrit të punimeve shkencore të botuara në revista të indeksuara në Web of Science (WoS) dhe Scopus	<ul style="list-style-type: none"> Ndërveprimi dhe puna ekipore e stafit në shkruarjen e punimeve shkencore 	<ul style="list-style-type: none"> Masat nxitëse sipas Rregullore së Universitetit për punën kërkimore-shkencore 	Këshilli i FE, Dekani, Stafi akademik, Këshilli Drejtues	2020-2024	40,000
Objektivi strategjik 3: Kontributi në komunitet						
3.1.	Zhvillimi i bashkëpunimit me Bordin Këshillëdhënës Industrial (BKI)	<ul style="list-style-type: none"> Organizimi i takimeve periodike dhe vjetore të BKI 	<ul style="list-style-type: none"> Pranimi i informacioneve nga BKI në funksion të sigurimit të cilësisë së programeve studimore 	Këshilli i FE, Dekani,	2020-2024	5,000

3.2.	Bashkëpunimi me komunitetin e biznesit, Alumni dha akterët tjerë në hartimin e programve studimore në harmoni me kërkesat e tregut	<ul style="list-style-type: none"> Organizimi i tryezave të rrumbullakëta, dhe punëtorive tematike me biznesin Organizimi i takimeve të përbashkëta informative me Alumni (studentët e diplomuar) 	<ul style="list-style-type: none"> Bashkë-organizimi i “Javës së karrierës” Këshillimi i vazhdueshëm me Alumni (studentët e diplomuar) 	Këshilli i FE, Dekani, Stafi akademik, Rektorati, Senati i Universitetit	2020-2024	5,000
3.3.	Bashkëpunimi në fushën e zhvillimit të praktikës profesionale të studentëve	<ul style="list-style-type: none"> Organizimi i takimeve për praktikë profesionale 	<ul style="list-style-type: none"> Lidhja e marrëveshjeve për praktikë profesionale me biznesin, OJQ, institucionet publike etj. 	Këshilli i FE, Dekani	2020-2024	2,000
3.4.	Ofrimi i shërbimeve vullnetare profesionale për nevojat e komunitetit	<ul style="list-style-type: none"> Identifikimi i nevojave të organizatave të ndryshme qeveritare dhe jo-qeveritare për ekspertiza të ndryshme 	<ul style="list-style-type: none"> Trajnimet projektet 	Këshilli i FE, Dekani	2020-2024	2,000
Objektivi strategjik 4: Procesi i ndërkombëtarizimit dhe rrjetëzimit						
4.1.	Rritja e numrit të marrëveshjeve me Universitete ndërkombëtare	<ul style="list-style-type: none"> Organizimi i takimeve me përfaqësues të universiteteve ndërkombëtare Ftesa për përfaqësuesit e universiteteve ndërkombëtare për vizitë dhe marrëveshje në Universitet 	<ul style="list-style-type: none"> Vizita në universitete ndërkombëtare Nënshkrimi i marrëveshjeve me fakultete simotra të Universiteteve të ndryshme ndërkombëtare 	Rektorati, , Zyra e për sigurimin e ilësisë, Zyra për marrëdhënie me jashtë, Këshilli i FE, Dekani	2020-2023	20,000
4.2.	Anëtarësimi në organizata/asociacione të fakulteteve me profil ekonomik	<ul style="list-style-type: none"> Identifikimi i organizatave /asociacioneve të fakulteteve me profil ekonomik Organizimi i takimeve me i organizata /asociacione të fakulteteve me profil ekonomik 	<ul style="list-style-type: none"> Nënshkrimi i marrëveshjeve me organizata/asociacione të fakulteteve me profil ekonomik 	Këshilli i FE, Dekani	2020-2023	8,000
4.3.	Rritja e mobilitetit të stafit akademik dhe të studentëve	<ul style="list-style-type: none"> Identifikimi i projekteve për mobilitet Pjesëmarrja në programet e Erasmus, Erasmus+ etj. 	<ul style="list-style-type: none"> Qendra për Inovacion dhe Punësim Programi Erasmus Programi Erasmus+ Programi Fullbright Jean Monnet 	Rektorati, Zyra për marrëdhënie me jashtë, Këshilli i FE, Dekani	2020-2024	20,000

4.4.	Bashkëpunimi me staf akademik ndërkombëtar për botimin e punimeve shkencore dhe organizimin e konferencave të përbashkëta	<ul style="list-style-type: none"> Publikime në revista ndërkombëtare të indeksuara me impakt faktor; Organizimi i konferencave shkencore ndërkombëtare me universitetet me renome; Sigurimi i përkrahjes për hartimin dhe menaxhimin e projekteve të përbashkëta (trajtime) 	<ul style="list-style-type: none"> Organizimi i dy konferencave vjetore Organizimi i një konference shkencore mbulohet nga buxheti i Universitetit; Bashkëorganizimi i një konference shkencore mbulohet nga fondet e përbashkëta të universiteteve dhe donatorët; 	Rektorati, Këshilli Drejtues, Zyra për marrëdhënie me jashtë, Zyra e projekteve, Këshilli i FE, Dekani	2020-2024	15,000
Objektivi strategjik 5: Zhvillimi i infrastrukturës						
5.1.	Përmirësimi i kapaciteteve të kabinetit të informatikës	<ul style="list-style-type: none"> Ndarja e buxhetit për rritjen dhe përmirësimin e kapaciteteve të kabinetit të informatikës 	<ul style="list-style-type: none"> Instalimi i rrymës Instalimi i 26 PC-ve Instalimi i Smart-Borad-it Rregullime infrastrukturore 	Këshilli i FE, Dekani, Zyra e TI, Donatorët	2020-2024	30,000
5.2.	Softveri për Analiza Statistikore dhe Ekonometrike	<ul style="list-style-type: none"> Ndarja e buxhetit për blerjen e softverit STATA Instalimi në PC 	<ul style="list-style-type: none"> Procedurat e blerjes online të STATA-ës 	Rektorati, Senati, Zyra e TI, Këshilli i FE, Dekani	2020-2024	5,000
5.3.	Rritja e fondit të titujve të librave dhe materialeve të tjera shkencore në Bibliotekën e FE	<ul style="list-style-type: none"> Ndarja e buxhetit për blerjen e librave Hartimi i listës së titujve të ri të librave Qasja në bibliotekat elektronike Përmirësimi i infrastrukturës 	<ul style="list-style-type: none"> Blerja e librave të rinj Qasja në bibliotekën elektronike 	Rektorati, Senati, Biblioteka, Zyra e TI, Këshilli i FE, Dekani	2020-2024	10,000
5.4.	Avancimi i teknologjisë së mësimdhënies dhe vlerësimit të njohurive të studentëve	<ul style="list-style-type: none"> Instalimi i softuerit për plagjiatur Organizimi i testimit elektronik 	<ul style="list-style-type: none"> Procedurat e prokurimit; Realizimi vetëm nëse proc. e prokurimit e mundësojnë furnizimin gjatë 6 muorit 2 i vitit 2020 	Rektorati, Dekani, Zyra e TI	2020-2024	5,000
5.5.	Përshtatja e sallave të mësimit me metodat e reja të mësimdhënies	<ul style="list-style-type: none"> Ndarja e buxhetit për blerjen e projektorëve, perdeve, tabelave dhe pajisjeve të tjera teknologjike 	<ul style="list-style-type: none"> Procedurat e prokurimit të fillojnë gjatë vitit 2020; Realizimi vetëm nëse proc. e prokurimit e mundësojnë furnizimin gjatë 6 muorit 2 i vitit 2020 	Rektorati, Dekani, Zyra e TI	2020-2024	10,000

Objektivi strategjik 6: Qëndrueshmëria financiare

6.1.	Projektet e përbashkëta me komunitetin lokal të biznesit	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Identifikimi i projekteve me interes të përbashkët me komunitetin ▪ Identifikimi i nevojave të biznesit dhe institucioneve tjera për shërbime profesionale 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Zbatimi i projekteve të përbashkëta me interes për komunitetin ▪ Trajnimi i stafit të Institutit kërkimore-shkencore për ofrimin e shërbimeve profesionale 	Rektorati, Institutet kërkimore-shkencore i FE; Zyra e financave	2020-2024	
6.2.	Projektet e përbashkëta kërkimore-shkencore me partnerët strategjik kombëtar dhe ndërkombëtar	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Hartimi i projekteve. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Identifikimi i organizatave dhe institucioneve ndërkombëtare për bashkëfinancim dhe përmeshje të objektivave strategjike të FE ▪ Identifikimi i kërkesave të institucioneve kërkimore ndërkombëtare dhe mundësia e bashkëpunimit me Institutin Kërkimor të FE 	Rektorati, Zyra për projekte; Instituti kërkimor-shkencore i FE	2020-2024	
6.3.	Gjenerimi i të hyrave vetanake nga hartimi i planeve të biznesit, nga ekspertizat për nevojat e komunitetit të biznesit dhe nevojat e institucioneve publike (gjykata, spitale, polici, auditim etj)	<p>Ofrimi i shërbimeve profesionale:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Studimet e fizibilitetit të bizneseve; ▪ Planet e biznesit; ▪ Hulumtimet e tregut; ▪ Shërbimet për gjykata; ▪ Shërbimet e kontabilitetit dhe auditimit; ▪ Shërbimet e konsulencës; ▪ Superekspertizat; ▪ Shërbime tjera profesionale 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Kontraktimi i shërbimeve duke përcaktuar afatet kohore të përmbartimit ▪ Krijimi i sistemit për evidentimin e shërbimeve ▪ Evidentimi i të hyrave të gjeneruara nga ofrimi i shërbimeve profesionale 	Rektorati, Zyra për projekte, Instituti kërkimor-shkencore i FE, Zyra e financave	2020-2024	
6.4.	Të hyrat nga pagesat e studentëve	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Provimet e studentave; ▪ Regjistrimet në studime baçelor dhe master; ▪ Paraqitja e temave baçelor dhe master 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Taksa e paraqitjes së provimeve ▪ Taksa e regjistrimit ▪ Taksa e paraqitjes së temave të diplomës 	Zyra e financave	2020-2024	